

AKSIDENTET RRUGORE

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure (ESMS)

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitja statistikore	2
5.1 Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit	5
9.1 Shpeshhtësia e shpërndarjes.....	6
10. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	6
11. Manaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	8
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koherenca dhe Krahueshmëria	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komentet	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Energjisë dhe Transportit, Drejtoria e Statistikave Sektoriale
1.3. Personi i kontaktit	Albana Osmënaj
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialiste në Sektorin e Statistikave të Energjisë dhe Transportit
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	aosmenaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 233356 / 233/ 240
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	28.10.2025
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	28.10.2025
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	28.10.2025
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore ofrojnë informacion për numrin e aksidenteve rrugore dhe të aksidentuarve në nivel vendi dhe qarku. Informacioni statistikor rreth aksidenteve rrugore është një tregues mujor i cili paraqet dinamikën e aksidenteve rrugore. Të dhënat të cilat INSTAT grumbullon dhe publikon mbi aksidentet rrugore janë: • Numri i aksidenteve rrugore; • Numri i të aksidentuarve i ndarë në numër të vdekur dhe plagosur sipas gjinisë; • Numri i aksidenteve sipas përdoruesve të rrugës; • Numri i të aksidentuarve sipas përdoruesve të rrugës; • Numri i aksidenteve sipas moshës së drejtuesit të mjetit; • Numri i aksidenteve rrugore sipas qarqeve;

	• Numri i të aksidentuarve sipas qarqeve; • Numri i aksidenteve rrugore sipas ditëve të javës dhe orës së ndodhjes së aksidentit.
3.2. Sistemi i klasifikimit	Nuk aplikohet.
3.3. Mbulimi i sektorit	Informacioni statistikor mbulon të dhënat mbi Aksidentet Rrugore të ndodhura në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.4. Konceptet statistikore dhe përkufizimet	Aksidente: Ngjarje e papritur, e padëshiruar ose e paqëllimshme ose një zinxhir specifik ngjarjesh të tilla që sjellin pasoja të dëmshme. Aksident me pasoja: Çdo aksident që përfshin të paktën një automjet rrugor në lëvizje në një rrugë publike ose private në të cilën publiku ka të drejtë hyrjeje, duke rezultuar në të paktën një person të plagosur ose të vrarë. I vdekur: Çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit, përjashtuar vetëvrasjet. I plagosur: Çdo person i cili si rezultat i një aksidenti nuk u vra menjëherë ose nuk vdiq brenda 30 ditësh, por pësoi një dëmtim për të cilin lind nevoja e një trajtimi mjekësor, duke përjashtuar vetëvrasjet në përpjekje. Sjellja e drejtuesit të mjetit: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj. Sjellja e këmbësorëve: Nënkupton aksidentet që ndodhin kur këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas “Kodit Rrugor” si: kalim ruge pa kujdes, etj.
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore janë numri i aksidenteve dhe të aksidentuarve.
3.6. Popullata statistikore	Të gjitha aksidentet rrugore dhe të aksidentuarit në këto aksidente të ndodhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.7. Zona e referencës	Të dhënat e aksidenteve rrugore mbulojnë të gjithë territorin e vendit.
3.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e Aksidenteve Rrugore datojnë prej vitit 1995.
3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	
4.1 Njësia matëse	Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore publikohen në vlerë absolute dhe në përqindje. Është përdorur numri si njësi matëse për treguesit e aksidenteve rrugore dhe të aksidentuarit. Vlerat në përqindje janë përdorur për të paraqitur ndryshimet mujore

	dhe vjetore.
5. Periudha e referencës	
5.1 Periudha e referencës	Informacioni statistikor mbi numrin e aksidenteve rrugore paraqitet në frekuencë tremujore për periudhën 1995-2015 dhe me frekuencë mujore nga viti 2016. Ky raport i përket vitit referencë 2025.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	Baza ligjore në nivel kombëtar mbi të cilat prodhohen Statistikat e Aksidenteve rrugore janë: • Ligjin Nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare”; • Programin Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026; • Memorandumi i Bashkëpunimit i hartuar me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Sipas rregulloreve Evropiane: • Vendimi i Këshillit 93/704/KE i datës 30 Nëntor 1993, "Mbi krijimin e një bazë të dhënash të Komunitetit për Aksidentet Rrugore.
6.2. Shkëmbimi i të dhënave	Statistikat e Aksidenteve Rrugore nuk transmetohen në Eurostat. Aktualisht, INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me Aksidentet Rrugore, të tilla si: Eurostat, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Federata Ndërkombëtare e Rrugëve (IRF), Forumi Ndërkombëtar i Transportit (ITF), etj.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligj Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare, si dhe Ligjin Nr. 124/2024, "Mbrotjtja e të Dhënave Personale". Neni 31, i Ligjit Nr 17/2018, "Për Statistikat Zyrtare" përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabela përmbledhëse të tilla që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të

	tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se: a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave; Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesit tek to, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojnë shkallën e detajimit që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojnë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vërtetuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.
8. Politika e botimit	
8.1. Kalendar i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftimet dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendar. Në rastin e vonesave, specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Akses në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve është i aksesueshëm në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Akses i përdoruesve	Në përputhje me nenin 34, të Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat zyrtare", statistikatat zyrtare shpërndahen në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë, përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përmbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet janë si më poshtë: 1. Website – press release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi Aksidentet Rugore; 4. Kërkesa për të dhëna, seksioni për përdoruesit e jashtëm.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	

9.1 Shpeshësia e shpërndarjes	Statistikat mbi “Aksidentet Rrugore” publikohen në bazë mujore.
10. Aksesit në të dhëna dhe qartësia	
10.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me Statistikat e aksidenteve rrugore për treguesit kryesorë. Format i njoftimit për shtyp nuk ka ndryshuar; ky format është përcaktuar nga sektori i publikimit, i cili vendos edhe datën e publikimit. Njoftimi për shtyp i Statistikave të Aksidenteve rrugore publikohet online në faqen e internetit të INSTAT nën temën: Transporti dhe Aksidentet .
10.2. Publikime	Rezultatet e Aksidenteve rrugore gjenden të botuara në botimin “Aksidentet Rrugore”, “Vjetarin Statistikor”, si edhe në “Vjetarin Statistikor Rajonal”. Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT: • Aksidentet Rrugore; • Vjetari Statistikor; • Vjetari Statistikor Rajonal.
10.3. Baza e të dhënave on-line	Të dhënat mbi Statistikat e Aksidenteve rrugore publikohen në faqen zyrtare të INSTAT në seksionin: Databaza Statistikore .
10.4. Aksesit në të dhënat mikro	Të dhënat e Aksidenteve Rrugore nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Këto të dhëna i shpërndahen përdoruesve sipas kriterëve të përcaktuar në nenin 31, Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat zyrtare".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Metodologjia mbi Statistikat e Aksidenteve rrugore është e bazuar në manualët dhe rregulloret e Eurostat, të cilat përmbajnë një set të gjerë rekomandimesh mbi plotësimin e treguesve të Statistikave të Aksidenteve Rrugore. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me metodogjinë mbi këto statistika.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Energjisë dhe Transportit, dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi Aksidentet Rrugore për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në ligjin “ Për Statistikat Zyrtare Nr.17/2018 ”, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të pranuar ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit

	të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT, për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Të dhënat e Aksidenteve Rrugore krahasohen me të dhënat e një viti më parë për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo nëse vihet re se ka ndryshime të mëdha.
12. Rëndësia	
12.1. Nevojat e përdoruesit	Përdoruesit e treguesve të aksidenteve rrugore ndahen në përdorues të brendshëm dhe të jashtëm. Me përdorues të brendshëm nënkuptojmë: • Sektorë të ndryshëm brenda INSTAT. Me përdorues të jashtëm nënkuptojmë: • Institucione të Administratës Publike; • Universitete; • Organizata jo fitimprurëse kombëtare dhe ndërkombëtare; • Biznese; • Kërkues, student edhe të tjerë grupe të ngjashme. Publikimi i treguesve të aksidenteve rrugore dërgohet çdo vit në një grup të caktuar përdoruesish. Disa tregues kryesorë dërgohen nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve të ndryshëm në: Eurostat, Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE), Federata Ndërkombëtare e Rrugëve (IRF), Common Questionnaire, etj.
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	INSTAT kryen çdo vit vërtetimin për matjen e Kënaqësisë së Përdoruesve. Rezultatet e vërtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e “Statistikave të Aksidenteve Rrugore” është vlerësuar me 3,82 (76.4%) nga një shkallë prej 1 (shumë dobët) në 5 (shumë mirë).
12.3. Plotshmëria	Plotshmëria e të dhënave për “Aksidentet Rrugore” për vitin 2025 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të parashikuara në rregulloret evropiane. Të dhënat e prodhuara mbi Statistikat e Aksidenteve Rrugore janë të detajuara sipas numrit të aksidenteve rrugore, numrit të të aksidentuarve (të vdekur apo të plagosur). Në Statistikat e Aksidenteve Rrugore nuk sigurohet informacion mbi numrin e aksidenteve pa të lënduar, numrin e të aksidentuarve sipas detajimeve (shofer, pasagjerë apo kalimtarë), shpërndarjen e numrit të të vdekurve sipas llojit të transportit si dhe shpërndarja e numrit të të vdekurve sipas llojit të zonës ku ndodh aksidenti, etj. Shkalla e plotshmërisë së të dhënave, për Statistikat e Aksidenteve Rrugore, është

	afërsisht 60%.								
13. Saktësia dhe besueshmëria									
13.1. Saktësia e përgjithshme	Informacioni mbi Aksidentet Rrugore grumbullohet nga burimet administrative, sipas detyrimit të zbatimit të bazës ligjore dhe Memorandumeve të Mirëkuptimit në fuqi. INSTAT nuk kryhen vrojtime për të dhënat e aksidenteve rrugore.								
13.2. Gabim i kampionimit	Nuk aplikohet pasi është burim administrativ.								
13.3. Gabim jo i kampionimit	Sa i përket gabimeve të jo kampionimit, fjala është kryesisht për disa gabime në raportimin e të dhënave nga burimet administrative. Rishikimi i të dhënave ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit.								
14. Afatet kohore dhe përpikmëria									
14.1. Afatet kohore	Rezultatet në lidhje me Aksidentet Rrugore publikohen rreth 28 ditë pas përfundimit të muajit referues sipas datës së paracaktuar në kalendarin e botimeve të INSTAT (T+28 ditë). <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>09/30/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>10/28/2025</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>28</td></tr> </table>	Periudha referuese	09/30/2025	Data e publikimit	10/28/2025	Afatet kohore	28		
Periudha referuese	09/30/2025								
Data e publikimit	10/28/2025								
Afatet kohore	28								
14.2. Përpikmëria	Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Statistikave mbi Aksidentet Rrugore ka qenë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve. <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>09/30/2025</td></tr> <tr> <td>Data e shpallur</td><td>10/28/2025</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>10/28/2025</td></tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td><td>0</td></tr> </table>	Periudha referuese	09/30/2025	Data e shpallur	10/28/2025	Data e publikimit	10/28/2025	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	09/30/2025								
Data e shpallur	10/28/2025								
Data e publikimit	10/28/2025								
Vonesa në kohë	0								
15. Koherenca dhe Krahueshmëria									
15.1. Krahueshmëria gjeografike	Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore janë hartuar në përshtatje me metodologjinë e Eurostat dhe si të tilla janë të krahueshme me vendet e BE apo vendet kandidate. Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore janë gjithëpërfshirëse, ato prodhohen në nivel vendi dhe sipas qarqeve.								
15.2. Krahueshmëria kohore	Informacioni statistikor mbi Aksidentet Rrugore grumbullohet duke datuar nga viti 1995. Nga viti 2007, të dhënat e aksidenteve sigurohen sipas një formati të caktuar elektronik të përcaktuar nga burimi administrativ dhe INSTAT duke siguruar një krahueshmëri kohore prej 19 vitesh (CC2=Jlast-Jfirst+1=19).								

15.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Nuk aplikohet.
15.4. Koherenca e brendshme	Kontrollohen konsistenca e brendshme e të dhënave para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablave dhe koherenca e tyre në seri të ndryshme. Një ndër to është kontrolli i variablave: "Numri gjithsej i aksidenteve rrugore" dhe "Numri i aksidenteve rrugore sipas sjelljes së drejtuesit/këmbësorit" nëse janë koherente.
16. Kostoja dhe ngarkesa	
16.1 Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e Statistikave të Aksidenteve Rrugore pranë Sektorit të Statistikave të Energjisë dhe Transportit është: 1 punonjës.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit të Statistikave të Aksidenteve Rrugore bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: • Politika e Revizionimit; • Politika e Trajtimit të Gabimeve.
17.2. Praktika e rishikimit	Në rast se autoritetet lokale të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Aksidentet Rrugore do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e muajit të ardhshëm shoqëruar me një shënim sqarues për përdoruesit. Nuk janë kryer rishikime mbi të dhënat e “Aksidenteve Rrugore” për vitin 2025, subjekt i këtij raporti.
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Burim administrativ, të dhënat grumbullohen nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. Mbulimi është gjithëpërfshirës në nivel vendi dhe qarku, të dhënat janë administrative dhe informacioni statistikor mundësohet në kohë.
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat grumbullohen në baza mujore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat mbi Aksidentet Rrugore janë të dhëna administrative. Informacioni statistikor i Aksidenteve Rrugore grumbullohet nga Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shteti dhe përmban informacion mbi numrin e aksidenteve rrugore të klasifikuara sipas gjinisë, sjelljes së përdoruesve të rrugës, moshës dhe sipas qarqeve në vend.

18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënave për Aksidentet Rrugore u janë bërë kontrolle logjike dhe matematikore. Këto kontrolle kryhen për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon, gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.
18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komente	
Aneks	